

 TRAINKOS SH.A.
TRAINKOS D.D.
TRAINKOS J.S.C.
Nr.No.Br. 2/134
Dt. 30.12.2016
Fushë Kosovë - Fushë Kosova - Kosovo Polje



U D H Ë Z I M
PËR ORGANIZIMIN E SHKOLLIMIT TË RREGULLT TË
PUNËTORËVE NË DEPARTAMENTIN E OPERIMEVE

Fushë Kosovë
Dhjetor 2016

Në mbështetje të Nenit 20 të Ligjit 04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike dhe në bazë të nenit 26.23 të Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Koorporative për NP, Rregullores 646, Bordi i Drejtorëve i Hekurudhave të Kosovës – TRAINKOS SH. A. në Mbledhjen Nr. 18 të mbajtur më 30.12.2016 miratoi këtë:

UDHËZIM

Për organizimin e shkollimit të rregullt të punëtorëve në Departamentin e Operimeve

DISPOZITAT HYRËSE

Neni 1 Qëllimi

Në këtë udhëzim përshkruhet mënyra dhe aplikimi i shkollimit të rregullt të punëtorëve të cilët marrin pjesë drejtpërdrejt në komunikacionin hekurudhor.

Neni 2 Fushëveprimi

Të gjitha dispozitat që kanë të bëjnë me mënyrën e shkollimit e që nuk janë të rregulluara me këtë udhëzim, aplikohen sipas Rregullores 646.

Neni 3 Përkufizimet

Me termin **praktikant** nënkuptohet - personi i cili ka të kryer shkollën e mesme profesionale për profesionet hekurudhore: frenues-manovrues, konduktori, udheheqës treni-ndihmes makinist, makinist dhe kontrollues i vagonëve, i cili themelon marrëdhënie pune për herë të parë në hekurudhë. Për kohën sa zgjatë puna provuese, praktikanti është i obliguar të fitojë njohuri të mjaftueshme lidhur me profesionin dhe të aftësohet për punë të pavarur në detyrat të cilat janë drejtpërdrejtë të lidhura me sigurinë në komunikacionin hekurudhor.

Neni 4

1. Aftësimi profesional është i obliguar për të gjitha profesionet (frenues-manovrues, konduktori, udheheqës treni-ndihmës makinist, makinist dhe kontrollues i vagonëve) për përgatitje

profesionale. Ligjeratat mbahen në vende ku janë të plotësuara kushtet për punë dhe ku praktikanti ka mundësi të njoftohet me punët praktike rreth profesionit konkret.

2. Në qoftë se praktikanti gjatë kohës së aftësimit profesional qëndron në pushim mjekësor i shtyhet afati i punës provuese për aq ditë sa ka qëndruar në pushim mjekësor.

3. Për përcjelljen e punës provuese udhëheqësi i drejtpërdrejtë cakton punëtorin profesionist (mentorin) i cili do të kujdeset për realizimin e suksesshëm të programit gjatë kësaj periudhe, dhe do të bëjë përgatitjen për dhënien e provimit profesional të kandidatit.

4. Praktikanti është i obliguar që gjatë kohës sa është në punë provuese të njoftohet me rregullat tekniko-teknologjike të vendit të punës si dhe të mbajë evidencë në fletore pune në të cilin regjistron punët me të cilat është njoftuar, punët të cilat i ka kryer nën mbikëqyrje e që dalin nga programi i punës, si dhe punët të cilat i ka kryer me vet iniciativë.

5. Praktikantit nuk i lejohet të kryej punë dhe detyra të punës në mënyrë të pavarur derisa të jep provimin profesional.

6. Praktikanti nuk mund ti nënshtrohet provimit profesional, nëse së pari nuk e ka kryer punën provuese sipas këtij udhëzimi dhe nëse nuk e ka kryer aftësimin profesional për profesionin për të cilin kërkon të jep provimin profesional.

7. Kohëzgjatja e aftësimit profesional, punës provuese dhe punës nën mbikëqyrje të praktikantit rregullohet si vijon:

- Praktikantët me përgatitje profesionale, (frenues-manovrues, konduktori,) më së paku 2 muaj;
- Praktikantët me përgatitje profesionale, udhëheqës treni - ndihmës makinist, më së paku 4 muaj
- Praktikantët me përgatitje profesionale (kontrolluesi i vagonëve, makinisti) më së paku 6 muaj;
- Praktikantët me përgatitje profesionale, (inxhiner i makinerisë bachelor, inxhinier i komunikacionit hekurudhor bachelor dhe inxhinier i elektros bachelor) më së paku 8 muaj;
- Praktikantët me përgatitje profesionale, (inxhinier i makinerisë master, inxhinier i komunikacionit hekurudhor master dhe inxhinier i elektros master) së paku 10 muaj;

Neni 5

Aftësimi profesional nën mbikëqyrje për praktikantët udhëheqës treni-ndihmës makinist realizohet përmes këtij programi në vijim

- Njohja e dispozitave mbi mbrojtjen personale dhe mbrojtjen në punë në njësinë ku bëhet aftësimi profesional.....1 javë
 - Njohja e dispozitave mbi mbrojtjen personale dhe mbrojtjen në punë në njësinë ku bëhet aftësimi profesional.....1 javë
 - njohja me punët dhe detyrat e punës së punëtorit të stacionit , ndërruesit të binarëve dhe frenues - manovruesi.....1 javë
 - njohja me punët dhe detyrat e depoistit të vagonëve 1 javë
 - njohja e punëve dhe detyrave të konduktorit..... 1 javë
 - njohja e punëve të udhëheqësit të trenit..... 1 javë
 - njohja e punëve të makinistit1 javë
 - njohja e punëve dhe detyrave të punës së kontrolluesit të vagonëve 1 javë
 - njohja me punët dhe detyrat e punës së drejtuesit të trenave 1 javë
- Puna nën mbikëqyrje në punët dhe detyrat të punës për udhëheqës treni-ndihmës makinist zgjat më së paku 2 muaj.

Neni 6

Praktikant bachelor inxhinier i komunikacionit hekurudhor, puna praktike për këtë pozitë zgjatë 8 muaj dhe realizohet përmes këtij programi

- njohja e dispozitave mbi mbrojtjen personale dhe mbrojtjen në punë në njësinë ku bëhet aftësimi profesional..... 1 javë
 - njohja me punët dhe detyrat e punës së punëtorit të stacionit, ndërruesit të binarëve dhe frenues - manovruesit..... 1 javë
 - njohja e punëve të personelit manovrues 2 javë
 - njohja me punët e frenuesit dhe udhëheqësit të trenave..... .1 javë
 - njohja me punët e makinistit1 javë
 - njohja e punëve dhe detyrave të punës së kontrolluesit të vagonëve1 javë
 - njohja me punët dhe detyrat e depoistit të vagonëve2 javë
 - njohja me punët e drejtuesit të trenave..... .2 javë
 - njohja e punëve të arkëtarit të mallrave – kalkulantis2 javë
 - njohja me punët dhe detyrat e punës komercialist2 javë
 - njohja me punët e shërbimit të mirëmbajtjes1 javë
 - njohja me punët në shërbimin e Stabilimenteve Sinjalizuese SS, Tele Komand TK dhe Energjetika EN 1 javë
- Puna nën mbikëqyrje si drejtues treni zgjat më së paku 3 muaj.

Neni 7

Praktikant master inxhinier i komunikacionit hekurudhor, puna praktike për këtë pozitë zgjatë 10 muaj dhe realizohet përmes këtij programi

- Njohja e dispozitave mbi mbrojtjen personale dhe mbrojtjen në punë në njësinë ku bëhet aftësimi profesional1 javë
 - Njohja me punët dhe detyrat e punës së punëtorit të stacionit, ndërruesit të binarëve dhe frenues – manovruesit1 javë
 - Njohja e punëve të personelit manovrues4 javë
 - Njohja me punët e frenuesit dhe udhëheqësit të trenave.....2 javë
 - Njohja me punët e makinistit2javë
 - Njohja e punëve dhe detyrave të punës së kontrolluesit të vagonëve1 javë
 - Njohja me punët dhe detyrat e depoistit të vagonëve..... 2 javë
 - Njohja me punët e drejtuesit të trenave.....8javë
 - Njohja e punëve të arkëtarit të mallrave – kalkulantit 2 javë
 - Njohja me punët dhe detyrat e punës komercialist..... 2 javë
 - Njohja me punët e shërbimit të mirëmbajtjes..... 1 javë
 - Njohja me punët në shërbimin e Stabilimenteve Sinjalizuese SS, Tele Komand TK dhe Energjetika EN 1 javë
- Punë nën mbikëqyrje si drejtues treni më së paku 3 muaj.

Neni 8

Veprimtaritë e komunikacionit–transportues Frenues-manovrues

Provimi profesional për kryerjen e punëve Frenues-Manovrues përbëhet prej pjesës teorike dhe praktike.

Neni 9

Provimi teorik

Pjesës së provimit teorik kandidati i nënshtrohet me gojë dhe përmban:

1. Rregullat e sinjalizimit;
2. Rregullat e komunikacionit;
3. Rregullat teknike;
4. Rregullat tjera;
5. Mbrojtja në punë.

Neni 10

Rregullat e sinjalizimit

1. Dispozitat e përgjithshme dhe kuptimi themelor i sinjalizimit, përdorimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve sinjalizuese, shenjat sinjalizuese të zileve elektrike, njohja themelore e shenjave sinjalizuese të përhershme; sinjaleve kryesorë, llojet, shenjat sinjalizuese, treguesit për binarë, sinjalet manovruese, sinjalet e peshoreve të vagonëve, sinjalet e ndërrueseve.
2. Sinjalet në trena, në manovruese, shtytëse, të mjeteve lëvizëse të caktuar - vagonëve dhe mjeteve lëvizëse të vijave hekurudhore. Shenjat sinjalizuese të personelit të trenave dhe të stacionit, shenjat sinjalizuese të personelit manovrues, sinjalet e personelit të hekurudhës.
3. Shenjat sinjalizuese; sinjali nuk vlen, sinori, kufiri i sektorit, vendi për ndalje, shenjat bartëse të hekurudhës, shenjat lokale të HK-Trainkos - SH. A.

Neni 11

Rregullat e komunikacionit

1. Vendet zyrtare të punës, përdorimi i personelit, orari, pranimi dhe dorëzimi i detyrës, shenjat zyrtare, rrespektimi i orarit të punës nga punëtorët e hekurudhës, stabilimentet e komunikacionit hekurudhor dhe stacioneve, llojet e vagonëve dhe shenjat e tyre. Manovrimin, lidhjen e trenave, lidhjen e trenit i cili shtyhet. Llojet e frejëve në mjete lëvizëse dhe caktimi i frejëve në tren, frenimi gjatë manovrimit.
2. Lëvizja e vagonëve me ngarkesa jo të rregullta, llojet, ndarja dhe shënjimi i mjeteve lëvizëse; shpejtësia nëpër ndërruese dhe brezin e ndërrueseve, lëvizja e trenave dhe vargut manovrues deri në një pikë të caktuar në binarë të hapur.
3. Njohuritë themelore për orarin e lëvizjes së trenave, mënyrën e lajmërimit të personelit manovrues për lëvizjen e trenave.
4. Njohuritë themelore për mjetet lëvizëse hekurudhore, mbylljeve të hekurudhës dhe ngjarjeve të jashtëzakonshme.
5. Dokumentin teknik dhe procesin teknologjik të stacionit.

Neni 12

Rregullat teknike

1. Karakteristikat themelore teknike të ndërrueseve, llojet e mjeteve lëvizëse dhe elementet përbërëse konstruktive të vagonëve së udhëtarëve dhe të mallrave.

Elementet themelore të pajisjeve sinjale-siguruese, stabilimentet vendosëse të ndërrueseve, bravave të ndërrueseve, rrëshqitëseve.

2. Elementet themelore të aparateve telefonike të radio-lidhjeve dhe të aparaturës zëruese dhe përdorimi i tyre në stacione ranguese dhe të mëdha.

Neni 13

Rregullat tjera

Seritë dhe nën seritë e vagonëve dhe shenjat e vendeve përkatëse, fletëzimin e vagonëve, fletëzat e vagonëve, fletëzat e shërbimit teknik të vagonëve, fletëzat transportuese – manipulative dhe fletëzat për shënimin e dërgesave të materieve të rrezikshme.

Neni 13

Mbrojtja në punë

1. Njohuritë themelore për mbrojtjen në punë.
2. Organizimi i mbrojtjes në punë për Frenues-Manovrues.
3. Përdorimi i rrobave mbrojtëse në vendin e punës.
4. Pajisjet mbrojtëse në vendin e punës.
5. Pajisjet për mbrojtjen nga zjarri, llojet dhe përdorimi i tyre.
6. Përdorimi i kutisë për ofrimin e ndihmës së parë në vendin e punës.

Neni 14

Provimi praktik

Provimi praktik jepet në atë mënyrë që kandidati e kryen detyrën në vendin e punës së frenues-manovruesit aq kohë sa i nevojitet komisionit që të verifikoj aftësitë praktike të kandidatit. Gjatë kohës së pjesës praktike të provimit komisioni e përcjell punën e kandidatit dhe i vlerëson aftësitë e tij për punë të pavarur.

Neni 15
Frenues-Manovruesi dhe ndërruesi

Provimi profesional për punët e frenues-manovruesit dhe ndërruesit përbëhet nga pjesa teorike dhe praktike.

Neni 16
Provimi Teorik

Kandidati i nënshtrohet pjesës së provimit teorik me gojë.

Neni 17
Rregullat e sinjalizimit

Të gjitha dispozitat e Rregullores së sinjalizimit.

Neni 18
Rregullat e komunikacionit

1. Njohuritë e përgjithshme dhe themelore në shërbimin e komunikacionit, vendet zyrtare të punës, mënyra e planifikimit dhe organizimit të punës së personelit, shenjat zyrtare, sjelljet e punëtorëve hekurudhor, orari, pranimi dhe dorëzimi i detyrës, stabilimentet e hekurudhës dhe të stacioneve, përdorimi i aparaturës lokale, përdorimi në vend i pajisjeve siguruese elektro-releike të ndërruesëve.

2. Dispozitat themelore të manovrimit kryerjen e punëve manovruese, lidhjen, pajisjeve për frenim, rrugë udhëtimit manovrues, marrëveshjen gjatë manovrimit, llojet e lëvizjes, manovrimi në binarët kryesor në vijë të hapur, masat e veçanta të sigurisë gjatë manovrimit, formimin e trenave, frejtë dhe frenimi i trenave, llojet dhe sistemi i frenimit, pajisjet e ndërrueseve të frejtëve me ajër, rubinetet e frenimit, lidhëset dhe frenuesit, vërtetimi i rregullsisë së frerëve, njohuritë themelore mbi peshën e nevojshme dhe të saktë të masës së frenimit, masa e frenimit.

3. Llojet, ndarja dhe shënjimi i trenave.

4. Ekstraktin nga orari i lëvizjes së trenave, lajmërimi i lëvizjeve të trenave në vende zyrtare në vijë hekurudhore, personelit të vijave, stacioneve dhe personelit të trenit.

5. Dokumentet përcjellëse të trenit, njohuritë themelore për urdhëresat e shkruara.

6. Numri dhe caktimi i personelit përcjellës të trenit në tren, e drejta e udhëtimit në mjetin lëvizës tërheqës, përgatitja e personave në trenat e mallrave.

7. Shpejtësia e lëvizjes nëpër ndërruese dhe nëpër brezin e ndërrueseve.

8. Rregullimi i lëvizjes së trenave, njohuritë themelore për leje, kryqëzim, tejkalim, avisim dhe çlajmërim.

9. Pranimi i trenave në stacion dhe përgatitja e tyre, llojet e takimeve të trenave dhe baza e kryqëzimeve të trenave, detyrat e ndërruesit tek sigurimi i komunikacionit, detyrat e personelit të trenit, formimi i trenit i cili shtyhet dhe lëvizja me shtytëse të palidhur.

10. Lëvizja e trenave dhe vargut manovrues, deri në një vend në vijë të hapur, tërheqja e trenit në vijë të hapur në stacionin e mbrapsëm.

11. Lëvizja e trenave në vija hekurudhore në të cilat në vende zyrtare ndërpritet detyra, ndërprerja dhe fillimi detyrës në vende zyrtare me kohë pune të kufizuar.

12. Kërkimi dhe ofrimi i ndihmës së trenave në vijë të hapur, lëvizja e motorëve hekurudhor dhe fletë lëshimet, mbyllja e vijave-binarëve, ngjarjet e jashtëzakonshme.

13. Vazhdimi i udhëtimit të trenit nga vija e hapët, lëvizja e trenit zyrtarë, ndihmës, veprimi kur treni nis nga binari i hapët që ka kërkuar ndihmë para se të arrijë lokomotiva ndihmëse, përdorimi i plugut të borës, veprimi kur vagonët ikën, dispozitat e përgjithshme për lëvizje të motorëve hekurudhor, lëvizja e motorëve hekurudhor në vija.

14. Njohuritë themelore për lidhjet telefonike hekurudhore dhe shfrytëzimin e tyre, dokumentin teknik dhe teknologjik të stacionit, evidencat e komunikacionit.

Neni 19

Rregullat e shërbimit të vagonëve

1. Njohja e llojeve të vagonëve, shënjimin e vagonëve me shenja të vendeve përkatëse, serive, nën serive dhe shenjat tjera dhe mbishkrimeve, pjesët lëvizëse të vagonëve.

2. Kontrollimin e vagonëve, pajisjet e vagonëve, vozitjet provuese, obligimet e personelit në lidhje me veprimin me vagon, njohja e vagonëve, njohuritë themelore lidhur me ngarkimin e vagonëve, fletëzimin e vagonëve dhe njohja e të gjitha fletëzimeve që përdoren për fletëzimin e

vagonëve dhe fletëzimet transporto-manipulative dhe fletëzimet për transport të dërgesave të materieve të rrezikshme.

3. Njohuritë themelore mbi përdorimin reciprok të vagonëve të mallrave dhe transportit ndërkombëtar dhe kthimin e vagonëve dhe pajisjet ngarkuese në vend.

4. Llojet e kontejnerëve dhe shënjimi i tyre.

Neni 20

Rregullat teknike

Karakteristikat themelore të ndërrueseve. Llojet e mjeteve lëvizëse, elementet themelore konstruktive të vagonëve të udhëtarëve dhe transportues (udhëzimi 52). Elementet themelore të pajisjeve sinjale-siguruese, pajisjet vendosëse të ndërrueseve, bravat e ndërrueseve, rrëshqitëseve, pajisjeve të bllok-elektrike, releike dhe vendosëset lokale. Elementet themelore të aparateve telefonike të radio-lidhjeve, aparaturës zëruese dhe përdorimi i tyre në stacione ranzhiruese.

Neni 21

Mbrojta në punë

1. Njohuritë themelore për mbrojtjen në punë
2. Organizimi i mbrojtjes në punë për Frenues-Manovrues dhe ndërruesi
3. Përdorimi i rrobave mbrojtëse në vendin e punës.
4. Pajisjet mbrojtëse në vendin e punës.
5. Pajisjet për mbrojtjen nga zjarri, llojet dhe përdorimi i tyre.
6. Përdorimi i kutisë për ofrimin e ndihmës së parë në vendin e punës.

Neni 22

Provimi praktik

Provimi praktik kalohet në atë mënyrë që kandidati e kryen detyrën në vendin e punës së frenues-manovruesit dhe ndërruesit për aq kohë sa i nevojitet komisionit që të vërtetoi aftësitë praktike të kandidatit. Gjatë kohës së pjesës praktike të provimit komisioni e përcjell punën e kandidatit dhe e vlerëson aftësinë e tij për punë të pavarur. Nëse komisioni e sheh të nevojshme mund të bëjë pyetje teorike nga programi i përgjithshëm i kryerjes së këtyre punëve dhe detyra të punës.

Neni 23
Udhëheqës manovre

1. Provimi profesional për kryerjen e punëve dhe detyrave të punës së udhëheqësit të manovrave përbëhet vetëm nga pjesa praktike e provimit.
2. Provimi praktik për udhëheqës manovre, përfshin vërtetimin e aftësisë profesionale për punë të pavarur në shërbim për aplikimin praktik të llogaritjes së gjatësisë, masës MNF(masa e nevojshme e frenimit) dhe MSF(masa e saktë e frenimit) të trenave, udhëheqjen e evidencave të nevojshme, shfrytëzimin e mjeteve ndërlidhëse dhe njohjen detale të procesit teknologjik të punës së stacionit.

Neni 24
Konduktorët

Provimi profesional për kryerjen e punëve të konduktorit, përbëhet prej pjesës teorike dhe pjesës praktike të provimit.

Neni 25
Provimi teorik

Provimit teorik kandidati i nënshtrohet me gojë dhe me shkrim. Pjesës me shkrim i nënshtrohet vetëm nga dispozitat e rregullores komerciale-transportuese dhe atë para pjesës së provimit me gojë.

Neni 26
Rregullat e sinjalizimit

Të gjitha dispozitat e Rregullores së Sinjalizimit.

Neni 27
Rregullat e komunikacionit

1. Përveç programit për frenues-manovrues dhe ndërrues, konduktorët i nënshtrohen edhe programit siç është në vijim:

2. Vagonët direkt, kurse në transport të brendshëm dhe ndërkombëtar, ndriçimin, nxehtjen dhe përgatitjen e vagonëve për transport të udhëtarëve, pranimi dhe dorëzimi i vagonëve të udhëtarëve në stacionet e nisjes, fundor dhe në stacionet e ndërrimit të personelit, detyrat e pranimit të trenit nga stacioni gjatë lëvizjes, gjatë ofrimit të trenit në vendin zyrtar ku treni duhet të qëndroj, gjatë kohës së pritjes në vende zyrtare dhe në stacionin e fundit të trenit. Veprimet gjatë ndaljes së jashtëzakonshme të trenit në vijë të hapur.

Neni 28
Rregullat e shërbimit të vagonëve

Sipas programit për frenues - manovrues, ndërrues.

Neni 29
Rregullat teknike

Sipas programit për frenues-manovrues dhe ndërrues.

Neni 30
Pajisjet tele-komunikuese

Teknika SS(Sinjalet Siguruese) dhe TT(Telefonia Teknike) hekurudhore, stabilimentet sinjale-siguruese, sinjalet e përhershme stabilimentet e ndërrueseve dhe rrëshqitëseve, stabilimentet për kontroll të binarëve, aparatet automatike dhe telekomanda, sigurimi i kalesave në nivel, lidhjet telefonike të vijave dhe stacioneve dhe shfrytëzimi i tyre.

Neni 31
Veprimtaritë transportuese-komerciale

1. Pjesa e provimit me shkrim, aplikimi praktik, llogaritja e çmimeve të udhëtimit rregullohet sipas dispozitave të aplikueshme të rregullores për organizimin e transportit të udhëtarëve.

Neni 32
Pjesa e provimit teorik
Rregullat ligjore dhe tarifore

Rregullat ligjore të aplikueshme në transportin hekurudhor, tarifat, konventat ndërkombëtare mbi transportin e udhëtarëve dhe bagazhit, tarifat për transport të udhëtarëve në komunikacion të brendshëm, llogaritja e çmimit të transportit dhe shtesat.

Neni 33
Mbrojtja në punë

1. Njohuritë themelore për mbrojtjen në punë
2. Organizimi i mbrojtjes në punë për Konduktor
3. Përdorimi i Uniformave në vendin e punës.
4. Pajisjet mbrojtëse në vendin e punës.
5. Pajisjet për mbrojtjen nga zjarri, llojet dhe përdorimi i tyre.
6. Përdorimi i kutisë për ofrimin e ndihmës së parë në vendin e punës.

Neni 34
Provimi praktik

Pjesa praktike e provimit përfshin aplikimin praktik të njohurive teorike dhe rregullat të cilat rregullojnë sigurinë e komunikacionit hekurudhor me këtë program.

Neni 35
Depoisti i transportit të mallrave

Provimi profesional për kryerjen e punëve të depoistit të transportit të mallrave përbëhet prej pjesës teorike dhe praktike të provimit.

Neni 36
Provimi teorik

Kandidati i nënshtrohet pjesës së provimit teorik me gojë.

Neni 37
Rregullat e komunikacionit dhe sinjalizimit

Dispozitat e komunikacionit dhe sinjalizimit jepen sipas programit të punës dhe detyrave të punëtorit në transportin e mallrave.

Neni 38
Rregullat e shërbimit të vagonëve

1. Shënjimim e vagonëve me shenjat përkatëse, të serive, nën serive, dhe me shenja të tjera.
2. Llojet e stacioneve në pikëpamje të shërbimit të vagonëve, njohja e të gjitha evidencave të parapara për stacion, mënyrën e përpilimit të dekadave dhe mujoreve të pranimit të vagonëve, barazimi i evidencave të vagonëve me evidenca të komunikacionit, shfrytëzimin e ndërsjellët të vagonëve të udhëtarëve, shfrytëzimi i përbashkët dhe barazimi i vagonëve të mallrave, dispozitat e përgjithshme mbi shfrytëzimin e ndërsjellët të vagonëve të udhëtarëve, vagonë zyrtarë dhe të mallrave në komunikacionin ndërkombëtar, hetuesinë për vagonë dhe mall, përpilimin e orarit të manovrave.
3. Porositjen, vendosjen, lajmërimin e vagonëve dhe pajisjet ngarkuese, kontrollimi i vagonëve para ngarkimit dhe shkarkimit, evidenca e pranim dorëzimit të vagonëve dhe pajisjeve ngarkuese në mes të shfrytëzuesit të transportit të mallrave, mbikëqyrje e ngarkimit të vagonëve, kujdesin për ngarkim dhe përdorimin e pajisjeve ngarkuese të drejtë, përpilimi i raportit mbi pa pastërtinë e vagonëve, veprimin me vagonë të huaj, veprimi pas shkarkimit, ringarkimit të vagonëve me pjesë të lujtshme dhe me pajisje ngarkuese, evidenca e pajisjeve ngarkuese, vendosjen dhe ruajtjen e pajisjeve ngarkuese, përpilimin e fletë përcjellëses për pajisje të ngarkimit dhe përgatitjet.

Neni 39
Rregullat komerciale-transportuese
Rregullat ligjore

Respektimi dhe aplikimi i ligjit mbi kontratat e transportit në komunikacionin hekurudhor, obligimet dhe kufizimi i transportit, transporti i materialeve dhe gjërat që pranohen në transport me hekurudhë nën kushte të parashikueshme, kontrata mbi transportin, fletëngarkesën lokale dhe ndërkombëtare, shfrytëzimi praktik i kontrollimit abecedik të materialeve dhe gjërave të rrezikshme, regjistrin e stacioneve kufitare të hapura për komunikacion të mallrave dhe regjistrin e numrave të lajmërimin të doganave ndërkombëtare.

Neni 40

Rregullat tarifore

Dispozitat e përgjithshme tarifore për transport të mallrave, regjistrin e stacioneve ku kryhet procedura doganore dhe a posedon peshore vagonësh, dispozitat mbi ngarkimin e vagonëve, transportin e vagonëve të shfrytëzuesit të transportit, transportin e kontejnerëve, përgatitja e trenit marshut të dërguesit me një fletëngarkesë, përdorimi praktik i Emërtuesit të stacioneve dhe Telemetrit në Hekurudhat e Kosovës -Trainkos- SH.A.

Neni 41

Rregullat manipulative-transportuese

Dispozitat themelore mbi manipulimin gjatë transportit të mallrave, punët që i paraprijnë pranimit të dërgesave në transport, pranimit të dërgesës në transport; transportimi i dërgesave dhe dorëzimi, dërgesat nga transporti ndërkombëtarë, konstatimi i përmbajtjes së dërgesave në transportin ndërkombëtar, peshimi dhe numërimi, lidhja e kontratave për transport (fletëngarkesën) rrugën e transportit për dërgesa të brendshme dhe ndërkombëtare, pranimit të dorëzimit të dërgesave në mes hekurudhave pjesëmarrëse në transport. Veprimi tek humbja e pjeseshme, tepicës, mungesës dhe dëmtimit të mallit. Përcjellësja K-316 procesi mbi shikimin K-320 (CIT 20) dhe fletëparaqitja mbi vjedhjen K-323; dispozitat e përgjithshme mbi procedurat e doganimit në komunikacionin hekurudhor, transportimi i dërgesave me vagonë, njohja e rrjetit hekurudhor dhe kalimet kufitare.

Neni 42

Mbrojtja në punë

1. Njohuritë themelore për mbrojtjen në punë
2. Organizimi i mbrojtjes në punë për Depoist të transportit të mallrave
3. Përdorimi i rrobave mbrojtëse në vendin e punës.
4. Pajisjet mbrojtëse në vendin e punës.
5. Pajisjet për mbrojtjen nga zjarri, llojet dhe përdorimi i tyre.
6. Përdorimi i kutisë për ofrimin e ndihmës së parë në vendin e punës.

Neni 43

Provimi praktik

Provimi praktik përfshinë verifikimin e aplikimit praktik të njohurive teorike të rregullave të cilat kanë të bëjnë me sigurinë e komunikacionit hekurudhor.

Neni 44
Udhëheqës treni-ndihmës makinist
Provimi teorik

Provimi teorik jepet me gojë dhe me shkrim, provimi me gojë përfshin lëmit e organizimit të transportit hekurudhor, njohurive dhe manipulimit të mjeteve tërheqëse.

Neni 45
Rregullat e Sinjalizimit

Të gjitha dispozitat e Rregullores së Sinjalizimit.

Neni 46
Rregullat e komunikacionit
Provimi me shkrim

Provimi me shkrim përfshinë përpunimin e materialit nga fusha e komunikacionit dhe formimit të trenave, konstatimin e përqindjes së frenimit dhe masën e nevojshme të frenimit të trenit (MNF) konstatimi i masës së saktë të frenimit (MSF), mbrojtjen e trenit dhe vendin e dëmtuar në vijë hekurudhore si dhe plotësimin e dokumenteve përcjellëse të trenit.

Neni 47
Provimi me gojë

1. Materia e paraparë me program për frenues-manovrues, ndërrues dhe përveç kësaj edhe ngarkimi dhe ngarkesa e vagonëve, detyrat dhe përgjegjësit e udhëheqësit të manovrave, manovrimi në binarët kryesor dhe në vijë të hapur, formimin e trenave, frejët dhe frenimi i trenit.
2. Të dhënat teknike për punimin dhe kryerjen e orarit të lëvizjes së trenave, materialin e orarit të lëvizjes së trenave, plani i punës dhe brutos në mes të stacioneve, përcaktimi i personelit të trenit, shfrytëzimin e personelit dhe lokomotivës, dokumentet përcjellëse të trenit, caktimi i personelit nëpër tren, e drejta e udhëtimit në mjetin tërheqës, përgatitja e personave në tren të mallrave dhe shpejtësia e trenit.
3. Kryerja e punëve në vende zyrtare me orar pune të kufizuar.

4. Lëvizja dhe përcjellja e trenave të posaçëm dhe zyrtar, lajmërimi i personelit të trenit për ndryshimet në lëvizjen e trenave, masat e sigurisë dhe rregullsisë së komunikacionit hekurudhor.

5. Përgatitja, ardhja dhe qëndrimi në stacion, shkurtimi i vonesës, pritja e trenit bashkangjites në lidhje të udhëtarëve, ndërrimi i takimeve të trenave dhe rënia e kryqëzimeve, detyrat e personelit të trenit te treni, dispozitat e veçanta për shtytje të trenit, dispozitat e veçanta mbi lëvizjen e trenit dhe vargut manovrues deri te një vend i caktuar në vijë të hapur dhe vozitje në kushte të veçanta.

6. Rastet kur është e nevojshme ndihma e trenit dhe mënyra e kërkimit të lokomotivës ndihmëse, veprimi kur treni i cili ka kërkuar ndihmë mund të vazhdojë lëvizjen para se të arrijë lokomotiva ndihmëse.

7. Lëvizja e motorëve hekurudhor si tren, ngjarjet e jashtëzakonshme.

8. Njohuritë themelore për mjetet lëvizëse tërheqëse-dizel, ndarja e mjeteve lëvizëse tërheqëse-dizel sipas grupeve dhe destinimit, shënjimi i mjeteve lëvizëse tërheqëse në HK, njohja e lidhjeve dhe pjesëve kryesore në mjetet lëvizëse tërheqëse-dizel, dizel motori, transmetuesi i fuqisë, bazamenti, pajisjet lëvizëse, njohuritë themelore mbi punën e dizel-maltorit, motorët dizel dy taktesh dhe katër taktesh, përshkrimi dhe principi i punës-dizel, injektimi i karburantit, përshkrimi i pjesëve përbërëse të dizel-motorit, përshkrimi dhe detyrat e pajisjeve për lubrifikim dhe ftohje të dizel-motorit dhe furnizimin me derivate, transmetuesit e fuqive, llojet e transmetuesve të fuqive, pajisjet komanduese në mjetet lëvizëse tërheqëse dhe përshkrimi i tabelës komanduese, përshkrimi dhe detyra e bazamentit të pajisjeve vrapuese, përshkrimi detal i gjeneratorit me avull, pjesët përbërëse, mënyra e punës, dhe përdorimi, njohja e shemës së gjeneratorit me avull, pajisjet për frenim-frejët, detyra e frejëve, përshkrimi dhe ndarja, përshkrimi dhe reagimi i frenit të dorës dhe frenit për rast rreziku, përshkrimi dhe principin e punës së frejëve me ajër, përshkrimi dhe detyrën e pajisjeve të zgjuesit (kontrolla e jetës), mënyra e vendosjes së sistemit radio – dispeçerike dhe informatave digjitale në mjetet lëvizëse tërheqëse.

Neni 48

Stabilimentet Tele-Komanduese

Sipas programit për profesionin e teknikut të komunikacionit dhe transportit.

Pajisjet për telekomandë, kontrolli i trafikut, pajisjet e terminalit në stacion, komandimi lokal dhe qendror i sinjaleve, ndërrueseve dhe rrugë-udhëtimi. Mënyra e procedimit të defekteve për larg dirigjimin e trafikut. Pajisjet auto pjesë, pajisjet bazë për ndalesë automatike të trenave, pajisjet e lokomotivës dhe hekurudhës, detyrat e përcjellësit të trenave gjatë defektit të pajisjes së autostopit.

Neni 49

Rregullat e telekomunikacionit

1. Paisjet TK (telekomanduese) dhe sistemi dispeçerik, organizimi i tyre dhe regjimi i punës me bllokun automatik të hekurudhës telekomand.
2. Radio lidhjet dispeçerike gjatë dirigjimit qëndror të trenave, drejtpërsëdrejti rregullimi i trafikut të trenave me radio lidhje dispeçer – makinist: pjesët e paisjeve themelore, principi i punës, elementi teknik, organizimi dhe njoftimi i paisjeve tjera të telekomunikacionit.

Neni 50

Rregullat e shërbimit të vagonëve

1. Materia e paraparë me program për frenues-manovrues dhe ndërrues e përveç kësaj edhe:
2. Udhëheqjen e ditarëve të vagonëve ditari i qarkullimit të vagonëve, llojet dhe mënyra e përdorimit të pajisjeve ngarkuese, pajisjet e vagonëve dhe evidentimi i vagonëve, pjesët luejtëse të vagonëve, përdorimi i vagonëve sipas vetive të tyre, porositja dhe revokimi i vagonëve, lajmërimi i gjendjes së vagonëve dhe pajisjeve ngarkuese, ndarja e vagonëve dhe pajisjeve ngarkuese, përdorimi i vagonëve të huaj transportues, evidentimi i dorëzimit të vagonëve dhe pajisjeve ngarkuese, udhëheqja e ditarit të ndarjes së vagonëve dhe brutos për përgatitje, konstatimi gjendjes së numrit të vagonëve në tren dhe stacione, përdorimi i vagonëve të udhëtarëve dhe mallrave në komunikacionin e brendshëm dhe atë ndërkombëtar.

Neni 51

Rregullat Teknike

1. Mjetet tërheqëse, lloji emri dhe mënyra e mirëmbajtjes, llojet e meremetimit dhe vozitjeve provuese, elementet kryesore në stabilimentet komanduese në kabinat e mjetit tërheqës.
2. Përdorimi i stabilimentit që shërben për shkyçjen e forcës tërheqëse në mjetin tërheqës, për frenimin e trenit, për dhënien e sinjaleve akustike me drita dhe sinjaleve për vërejtje, rigorozisht ndalimi i disa veprimeve në mjetin tërheqës.
3. Elementet themelore dhe principi i punës së auto-stop stabilimentit, rëndësia e përdorimit të telefonit dhe radio-lidhjeve në vendet zyrtare.

Neni 52

Mbrojtja në punë

1. Njohuritë themelore për mbrojtjen në punë
2. Organizimi i mbrojtjes në punë për Udhëheqës treni-ndihmës makinist
3. Përdorimi i Uniformave në vendin e punës.
4. Pajisjet mbrojtëse në vendin e punës.
5. Pajisjet për mbrojtjen nga zjarri, llojet dhe përdorimi i tyre.
6. Përdorimi i kutisë për ofrimin e ndihmës së parë në vendin e punës.

Neni 53

Provimi Praktik

1. Pjesa praktike e provimit profesional për udhëheqës treni-ndihmës makinist përbëhet nga konstatimi i njohurive praktike dhe aplikimin e dispozitave të cilat kanë të bëjnë me kryerjen e punëve të udhëheqësit të trenave-ndihmës makinistit nga lajmërimi në detyrë dhe pranimin të trenit deri te dorëzimi të tij në stacionin e fundit. Gjatë kësaj përcillet puna e udhëheqësit të trenave-ndihmës makinisti tek pranimi i flet udhëtimit të trenave, urdhëresave, planit të punës, mënyra e përdorimit të lokomotivës, nisja nga stacioni, vozitja në hekurudhë, vrojtimi i sinjaleve, udhëheqjen e flet udhëtimit, manovrimet nëpër stacione dhe dorëzimi i trenit.
2. Përveç aplikimit praktik dhe konkret të rregulloreve komisioni vërteton edhe njohuritë teorike të kandidatit edhe në raste tjera.

Neni 54

Bachelor-inxhinier i komunikacionit dhe master-inxhinier i komunikacionit

Provimi profesional për bachelor inxhinier dhe master inxhinier të komunikacionit përbëhet nga programi i paraparë për teknik të komunikacionit hekurudhor dhe organizimit të komunikacionit hekurudhor, i cili jepet njëkohësisht me provimin teorik për teknik të komunikacionit hekurudhor sipas rregullores 646.

Neni 55

Organizimi i komunikacionit

Organizimi i punëve në stacione për formimin dhe shformimin e trenave, organizimi i punës manovruese, teknologjia e përpunimit të trenit, analiza e gjendjes ekzistuese dhe propozimi për

mekanizimin dhe automatizimin e stabilimenteve themelore të stacionit, varësia reciproke e punës së stabilimenteve dhe elementeve të stacionit dhe vijave kaluese (lidhëse), teknologjia e përpunimit të brutos lokale, analizat, planifikimi dhe udhëheqja me punën e stacionit, organizimi i lëvizjes së vagonëve dhe trenave nëpër nyje, teknologjia dhe procesi i shërbimit të udhëtarëve (arkës së udhëtarëve dhe tjera), analiza e punës së stacionit në bazë të dhënave themelore, organizimi i vendosjes së brutos në vende për shkarkim dhe ngarkim, analiza dhe propozimi i masave për zvogëlimin e qëndrimit të vagonëve në stacion, kapacitetin e stacionit dhe stabilimenteve tjera të stacionit, intervalet e stacionit, fytet e ngushta dhe masat për ti eliminuar ato; masat për avancimin e punës së stacionit, organizimi i punës së stacioneve të mallrave, kapaciteti i stacioneve të mallrave, plani i formimit të trenit, mundësia e përpunimit dhe lëshuarjes së vijës, marshutizimi i trenave.

Neni 56

Veprimtaria e tërheqjes dhe mjetet tërheqëse Ndihmës makinisti i mjeteve tërheqëse – dizel

Provimi profesional për ndihmës makinist të mjeteve tërheqëse – dizel përbëhet prej pjesës teorike dhe praktike të provimit.

Neni 57

Provimi teorik

Kandidati i nënshtrohet pjesës së provimit teorik me gojë.

Neni 58

Njohja e mjeteve tërheqëse-dizel

Njohuritë themelore për mjetet lëvizëse tërheqëse-dizel, ndarja e mjeteve lëvizëse tërheqëse-dizel sipas grupeve dhe destinimit, shënjimi i mjeteve lëvizëse tërheqëse në HK, njohja e lidhjeve dhe pjesëve kryesore në mjetet lëvizëse tërheqëse-dizel, dizel motori, transmetuesi i fuqisë, bazamenti, pajisjet lëvizëse, njohuritë themelore mbi punën e dizel-malorit, motorët dizel dy taktesh dhe katër taktesh, përshkrimi dhe principi i punës motorit-dizel, injektimi i karburantit, përshkrimi i pjesëve përbërëse të dizel-malorit, përshkrimi dhe detyrat e pajisjeve për lubrifikim, ftohje të dizel-malorit dhe furnizimin me derivate, transmetuesit e fuqive, llojet e transmetuesve të fuqive, pajisjet komanduese në mjetet lëvizëse tërheqëse dhe përshkrimi i tabelës komanduese, përshkrimi dhe detyra e bazamentit të pajisjeve vrapuese, përshkrimi i detajit të gjeneratorit me avull, pjesët përbërëse, mënyra e punës, dhe përdorimi, njohja e shemës së

generatorit me avull, pajisjet për frenim-frejët, detyra e frerëve, përshkrimi dhe ndarja, përshkrimi dhe reagimi i freni të dorës dhe frenit për rast rreziku, përshkrimi dhe principin e punës së frejëve me ajër, përshkrimi dhe detyrën e pajisjeve të zgjuesit-zgjuesi, mënyra e vendosjes së sistemit radio-dispečerike dhe informatave digjitale në mjetet lëvizëse tërheqëse.

Neni 59

Shërbimet teknike dhe kujdesi ndaj mjeteve lëvizëse dhe tërheqëse-dizel

Përgatitja e mjetit tërheqës-dizel për rrugë, ngrohja e garniturave të udhëtarëve, veprimi pas kthyerjes nga rruga, sigurimi i mjetit tërheqës në kushtet e dimrit.

Neni 60

Rregullat e shërbimit të tërheqjes dhe rregullave tjera

1. Rregulloren mbi tërheqjen në HK, udhëzimin për punën e personelit të mjeteve tërheqëse pjesën e cila ka të bëjë me dizel lokomotivave, rregullat e ruajtjes së sigurisë personale, udhëzimin e masave preventive kundër zjarrit dhe veprimi në rast zjarri.
2. Njohuritë themelore të pajisjeve sinjale-siguruese, stabilimentet e vendosëseve të ndërrueseve, bravat e ndërrueseve, rrëshqitëseve.
3. Elementet themelore të aparateve telefonike, radiolidhjeve dhe stabilimenteve të zërimit dhe aplikimi i tyre.

Neni 61

Rregullat sinjalizuese

Të gjitha dispozitat e Rregullores së sinjalizimit.

Neni 62

Rregullat e komunikacionit

Vendet zyrtare të punës, përdorimi i personelit, stabilimentet hekurudhore të stacionit dhe të komunikacionit, manovrimin, lidhjen dhe zgjidhjen e mjeteve lëvizëse. Përdorimi dhe pranimi i lokomotivës, të drejtën e udhëtimit në lokomotivë, pajisjet e lokomotivës. Frenimi trenit dhe prova e fyejve, sigurimi i mjeteve lëvizëse dhe trenin nga vetëlëvizja. Llojet e trenave dhe

shënjimi i trenit, formimi i trenit dhe urdhëresat me shkrim, lajmërimi i lëvizjes së trenit, njohja detale e dokumenteve përcjellës të trenit, përgatitja e trenit, detyrat në stacionin e nisjes së trenit, gjatë kohës së vozitjes, qëndrimin në vende zyrtare dhe stacionin e fundit. Jashtëzakonisht ndalja e trenit në vijë tërhapur dhe masat e sigurisë, ndalje dhe kalim i jashtëzakonshëm nëpër vende zyrtare. Lëvizja e trenave në vija me kohë të punës së kufizuar dhe vija të pajisura me telekomandë. Vozitja e lokomotivave ndihmëse. Mbyllja e vijës-binarit dhe ngjarjet e jashtëzakonshme.

Neni 63

Mbrojtja në punë

1. Njohuritë themelore për mbrojtjen në punë
2. Organizimi i mbrojtjes në punë.
3. Përdorimi i Rrobave Mbrojtëse dhe Uniformave në vendin e punës.
4. Pajisjet mbrojtëse në vendin e punës.
5. Pajisjet për mbrojtjen nga zjarri, llojet dhe përdorimi i tyre.
6. Përdorimi i kutisë për ofrimin e ndihmës së parë në vendin e punës.

Neni 64

Provimi praktik

Provimi praktik përfshin aplikimin praktik të njohurive teorike dhe rregullat të cilat të cilat janë të parapara me këtë program. E posaçërisht se si kandidati i përvetëson në punë, shpejtë dhe sigurt ta ndal trenin dhe ndaljen e mjetit lëvizës tërheqës për tren, aftësinë e dhënies së të gjitha shenjave sinjalizuese prej mjetit lëvizës tërheqës të cilat e jepë makinisti dhe pranimi i sinjaleve të personelit të vijave dhe stacioneve, përdorimi i gjeneratorit me avull, veprimin praktik të disa pjesëve dhe stabilimenteve në mjetin lëvizës tërheqës. Provimin praktik kandidati e kalon në mjetin tërheqës-dizel tek tërheqja e trenit të caktuar në mesë të stacioneve ose në depo, për çka vendos komisioni pyetës.

Neni 65

Teknik i tërheqjes–makinist i mjeteve lëvizëse tërheqëse –dizel

Provimi profesional për punë dhe detyra të punës së makinistit të mjeteve lëvizëse tërheqëse-dizel përbëhet nga pjesa praktike dhe teorike e provimit.

Neni 66
Provimi teorik

Kandidati i nënshtrohet pjesës së provimit teorik me gojë.

Neni 67
Njohja e mjeteve lëvizëse tërheqëse-dizel

Njohuritë e përgjithshme mbi mjetet lëvizëse tërheqëse-dizel, llojet, përbërja dhe fuqia, shënjimi i mjeteve lëvizëse tërheqëse në HK-Trainkos- SH. A. ndarja e mjeteve lëvizëse tërheqëse-dizel sipas aplikimit, të dhënat teknike, përshkrimi dhe vendosja e pjesëve kryesore në mjetin lëvizës tërheqës-dizel, përshkrimi dhe principi i punës së mjetit lëvizës tërheqës-dizel.

Neni 68
Pjesa mekanike

1. Dizel-motorët, ndarja e dizel-motorëve sipas karakteristikave, përshkrimi dhe principi i punës së dizel-motorit, përshkrimi dhe funksioni i pjesëve përbërëse të motorit-dizel (rregullatorit të numrit të rrotullimeve, rregullatori i ngarkesës, pompës për furnizim me karburant, shtëpizës, karterit, koledokut, kushinetave, stabilimenteve siguroese për mbikalim të numrit të rrotullimeve dhe tjera), sistemin e karburantit, ftohjen e ujit, lubrifikimit dhe ajrit, përshkrimi i pajisjeve dhe rëndësia, përshkrimi i stabilimenteve për lëshim në punë të dizel-motorit, përshkrimi, detyra dhe principi i punës së kompresorit, përshkrimi dhe detyra e regjimit të punës së dizel-motorit, bllokimi mekanik në tabelën komanduese; përshkrimi, detyra dhe principi i punës së stabilimenteve siguroese, sistemi i nxehjes dhe klimatizim tek mjetet lëvizëse motorike-dizel, sistemi i pajisjeve të ranoreve, ndërprerësin izolues, ndërprerësi në tabelën komanduese të dizel-motorit.

